REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 18,29/23
Datë/Datum. 19.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

EKSPERT SHQYRTUES	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Rrahim Ademi	*11.01.2023*	19.01.2023	18,29/23

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **06.01.2023,** OE **"BOTEK"sh.p-k.** dhe më **10.01.2023** OE **Future BITS shp.k.** kanë parashtruar ankesë me nr: **18,29/23**, kundër **Njoftimit për Kontratë** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi me tabela të menqura"** me nr. të prokurimit: **616-22-14100-1-1-1 ,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS.**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës FURNIZM, vlera e parashikuar e kontratës: **400.000.00** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE "BOTEK"sh.p.k. DHE OE Future BITS sh.p.k.

OE **"BOTEK"sh.p-k**

1.Shkeljet e dispozitave të ligjit nr.04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjit Nr.05/L-068 dhe ligjit Nr.05/L-092

-Neni 7: Barazia,Trajtim/Ko-Diskriminimi

-Neni 53:Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

2.Shkeljet e dispozitave-Rregullat dhe udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik Nr 001/2022

-Neni 24: Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore

-Neni 63: Vendimi i Autoriteit Kontraktues

OE Future BITS shp.k.

Neni 7 i LLP-se, Barazia ne trajtim / jo-diskriminimi
Neni 27 i LPP-se, Dosja e tenderit
Neni 28 i LPP-se, Specifikimet teknike
Neni 53 i LPP-se, Sigurimi i informatave shtese per kandidatet dhe tenderuesit
Neni 64 i LPP-se, Deshmite e kerkesave
Neni 69 i LPP-se, Aftesa Teknike dhe/ose Profesionale
Nni 70 i LPP-se, Standardet per sigurimin e cilesise

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

1. Pas publikimit të dosjes së tenderit nga ana e AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në ***FDT Pika 9.1&9.2 Kërkesa mbi mundësit teknike / profesionale,*** kemi konstatuar disa kërkesa për dokumente shtesë dhe diskriminuese, gjegjësisht potencialisht favorizuese për ndonjë OE të caktuar nga AK, e të cilat e pamundësojnë pjesëmarrjen e më shumë OE në këtë aktivitet të prokurimit.

AK ka kërkuar kopje të noterizuara të disa certifikatave të prodhuesit si; ***"Certifikata e kualitetit për shpenzim minimal të energjisë", "Certifikata që produkti ka kaluar testet kundër zjarrit dhe Certifikata se produkti ka kaluar testin e ndryshkjes korrozionit"***. Këto certifikata janë kërkuar kopje të noterizuara për vitin 2022.

Këtu edhe qëndron tendenca diskriminuese (gjegjësisht favorizuese për ndonjë OE të caktuar) nga ana e AK, e cila me kërkesa të tilla krejtësisht të panevojshme teknikisht & profesionalisht, kufizon konkurrencën skajshmërish, duke pamundësuar / kufizuar pjesëmarrjen e më shumë OE në tender.

Prodhuesit e pajisjeve të kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit, janë prodhues botëror (si LG, Samsung, SmartTech, NEC, IIAMA etj etj) ndërsa certifikatat e kërkuara nga ana e AK, gjenden në web sitet e tyre dhe mund të verifikohen lehtësisht në çdo kohë nga AK apo kushdo tjetër.

Prandaj, kjo kërkesë për certifikatat e sipërpërmendura të noterizuara jo vetëm se është e panevojshme por edhe e pamundur ligjërisht, pasi që këto certifikata Origjinale NUK ka mundësi Prodhuesit të ua dërgojnë OE nëpër botë, por ne si OE të njëjtat i marrim në formë digjitale duke i shkarkuar nga Web Site apo AK i verifikon vet direkt, mirëpo si të tilla, *me **Ligjin për Noterinë në Kosovë Nr 06/L-01, Neni 47*** - **Vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale, nuk mund të noterizohen.**

Për të vërtetuar edhe njëherë këtë, ne kemi kërkuar nga disa noterë nëse mund të bëhen noterizimi i kopjeve të certifikatave të dërguara nga prodhuesit, mirëpo ata na kanë sqaruar se noterizimi mund të bëhet pasi të prezantohet certifikata origjinale në formë fizike, cka në këtë rast dhe raste të ngjashme është e pamundur!

Prova 1_Përgjigjet nga Noterët

2. Me datë 19.12.2022, përveç çështjes së Certifikatave sikurse në piken 1, ne kemi kërkuar sqarime shtesë nga AK, përmes Kërkesës për informacione shtesë, në total gjashtë (6) kërkesa, ndërsa AK na është përgjigjur në vetëm njërën prej tyre.

   Kështu, AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe RRUOPP-së, pasi që për pesë (5) kërkesat e tjera, nuk ka kthyer asnjë përgjigje, refuzuese ose pranuese, sikurse kërkohet me LPP **Neni 53 i LPP Nr. 04/L-042 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit, paragrafi 5:** *"Nëse autoriteti kontraktues konstaton se operatorët ekonomik nuk kanë nevojë për informatat e kërkuara, autoriteti kontraktues menjëherë do t'i njoftojë mbi refuzimin e kërkesës me shkrim operatorit përkatës ekonomik"*; dhe RRUOPP **Pika 24 e RRUOPP Nr.001/2022 ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore, paragrafi 4:** *"AK do të shqyrtoj menjëherë kërkesën sipas paragrafit 24.3 të kësaj rregullore dhe do të konstatoj nëse informata shtesë ose sqarimi i kërkuar është i nevojshëm apo jo:*

   - Nëse jo AK do të informoj menjëherë, përmes platformës, OE në fjalë për mohim.

   - Nëse po AK do të ofrojë informatat shtesë menjëherë, përmes platformës, por nuk do të bëjë të ditur burimin e kërkesës së tillë.

Ndërsa AK, nuk i ka marrë fare parasysh kërkesat tona për sqarime shtesë të dosjes, duke i injoruar krejtësisht ato dhe duke mos infromuar OE per mohim/refuzimin e kërkesave, përkundër faktit se janë konstatuar mospërputhje të mëdha në mes të **Kërkesave në FTD**, Anexi 1 **Specifikimet teknike të detyrueshme** si dhe atyre ne **Kushtet e Veçanta** dhe **Përshkrimi i çmimeve**, që e bënë të pamundur përgatitjen dhe dorëzimin e një oferte të përgjegjshme nga cilido OE në këtë rast!

Për ti vërtetuar këto pretendime tona, ju lutem referojuni provës 2 si në vijim ku të hijezuara me ngjyrë të verdhë janë kërkesat tona për të cilat nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga ana e AK

Prova 2_Kërkesa për informacion shtesë dhe përgjigja nga AK

3. Pas pranimit të përgjigjeve të mangëta nga AK, ne kemi vazhduar me ***Kërkesën për Rishqyrtim*** (datë 23.12.2022), ku kemi kërkuar edhe njëherë nga AK, përgjigje në kërkesat tona për sqarime të dosjes së tenderit.

Me datë **29.12.2022**, AK ka publikuar Vendimin, përmes së cilës ka aprovuar pjesërisht Kërkesën tonë për Rishqyrtim, duke larguar tre (3) kritere dhe për pikat tjera NUK ka dhënë asnjë përgjigje.
Sa për sqarim, ne nuk kemi kërkuar largimin e kriterit / kërkesës rreth certifikatave, por kemi kërkuar largimin e kërkesë për dorëzim të ***kopjeve e certifikatave të noterizuara***, për arsyet e cekura në pikën 1 të kësaj ankese.

Pra është e pashpjegueshme, se si AK ka larguar krejtësisht kërkesën për dy certifikata (6&7), ndërsa për njërën nuk ka mundësuar të paktën largimin e kërkesës për kopjen e certifikatës së noterizuar.

Sërish, edhe pas Vendimit në kërkesën për Rishqyrtim nga ana e AK, ku na ishin aprovuar pjesërisht disa nga kërkesat, ne nuk kemi marrë asnjë sqarim për kërkesa për sqarime shtesë nr. 2, 3,4 & 5 si dhe pikën 1 të kërkesës nr 6.

Poashtu, vendimi nga AK është i mangët, pasi që nuk plotëson kriteret sipas dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP-së (Neni 63), sepse ky vendim nuk jep përgjigje në pretendimet tona në KpR si dhe nuk përmban kështillën juridike në fund. Pra, nuk ka marrë parasysh kërkesat tona, duke pranuar ose refuzuar ato, respektivisht duke dhënë arsyetim për refuzimin e tyre.

Pas këtij vendimi, ne me datë 30.12.2022, me qëllim të evitimit të prolongimit të kësaj procedura, duke shkuar me ankesë pranë OSHP, ne kemi dërguar parashtresë përmes e-maillit dhe e-prokurimit, tek AK, duke kërkuar edhe një herë nga AK që të na ofrojnë sqarime në kërkesat tona, të cilat vlerësojmë që janë të domosdoshme për një aktivitet të prokurimit të drejtë.

Mirëpo, AK në të njejtën ditë, na kthejnë një e-mail aspak profesional dhe të papërshtatshëm për një institucion sikurse KK Prishtinë, *duke na akuzuar padrejtësisht në diktim të politikave të brendshme të AK-së, përkundër faktit se* ne si OE kemi kërkuar vetëm aplikimin e drejtë të ligjeve në fuqi, gjithnjë duke synuar parandalmin e shkeljes së tyre nga AK.

Bazuar në të gjitha shpjegimet dhe provat e lartshënuara, kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së që:

- **Ankesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar,**
- **Të obligoj Autoriteti Kontaktues ti bëjë ndryshimet e nevojshme të specifikave teknike dhe kërkesave tjera diskriminuese dhe të njëjtat t'i hartojë në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Lidhur me aktivitetin **616-22-14100-1-1-1**, duke pare kriteret qe na pamundesojne pjesemarrjen ne projekt, kemi bere dy kerkesa drejtuar autoritetit kontraktues Komuna e Prishtines, para dorezimit te ofertave:

1. **Sqarime Shtese me datë 19.12.2022,** ku pas pranimit te vendimit te AK-se te dates **22.12.2022** ndaj sqarimeve shtese nuk pajtohemi me pergjigjet e autoritetit, derisa AK ne disa pyetje shume te rendesishme per kete aktivitet qe i kemi parashtruar nuk na ofroj pergjigje fare.

2. **Kërkesën për Rishqyrtim me datë 23.12.2022,** ku kemi kerkuar te largohen kriteret diskriminuese ne **FDT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** pika **9.1 & 9.2** me numrat rendor **4,5,6,7** dhe kerkesat e tjera per **specifikimet teknike** dhe **cilit specifikim duhet ti permbahemi.**

Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtines me vendimin e dates **29.12.2022** ne pergjigjen e tyre ndaj kerkesave per rishqyrtim del me pergjigje te shkurte, derisa per pyetjet e tjera te ngritura nga ne nuk pergjigjet prap ne vendimin e tyre.

Ne vijim pergjigja e autoritetit ndaj kerkesave per rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues vendos qe te largoj nga formulari i dosjes se tenderit ne piken 9.1. dhe 9.2., kriterin me nr.6, 7 dhe 10.

AK ne vendimin e dates ***29.12.2022*** largon kriteret ***6,7*** *te pikes* ***9.1 & 9.2*** *te* ***FDT-se,*** e per me teper largon edhe kriterin kryesor per pergjegjshmerine e ofertave kriterin ***nr.10*** apo Katalogun dhe videoprezentimet e produktit, e me kete rast e bene edhe me te veshtire vleresimin e ofertave.

AK, nuk na eshte pergjigjur fare rreth pyetjeve te **specifikimit teknik** dhe pavaresisht operatoreve ekonomik AK nuk mundet ne asnje rrethane te vazhdoj kete aktivitet derisa te rregulloj kriteret e brendshme te aktivitetit, sepse autoriteti kontraktues ka 2 specifikime teknike per te njejtin aktivitet, e qe eshte ne kundershtim me LPP-ne, e per kete edhe kemi bere pyetje ne sqarime shtese dhe kerkese per rishqyrtim mirepo jemi pa pergjigje.

Ne kerkojme prap te na sqarohet se cilit specifikim duhet ti permbahen operatoret sepse ka dy specifikime ne Eprokurim per te njejtin aktivitet:

a). Specifikacion-tabelat interactive dhe

b). Përshkrimi i çmimeve,

Prandaj kerkojme qe Organi shqyrtues i prokurimit te shtjelloj se cilit specifikim duhe ti permbahemi a) apo b), pasiqe eshte kushti kryesor dhe i vetem ne baze te cilit do te behet evaluimi si dhe vertetimi i pergjegjshmerise se ofertuesve, AK per kete kerkese duhej te na ofronte pergjigje.

KERKESA 1:

*Ne FDT te **Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2** pretendojme se jane bere kerkesa te cilat jane totalisht te paqarta dhe diskriminuese, pra kriteret e mbetura (certifikatat) **Nr.4 dhe 5**, te cilat duhet larguar nga FDT dhe te na mundesohet pjesemarrja me kritere te drejta, te barabarta e jo diskriminuese.*

Kriteri Nr.4, tek FDT pika 9.1&9.2:
Ne kete kriter te vendosur ne DT, *AK ka kerkuar qe produkti i ofruar te posedoj certifikaten e kualitetit per shpenzim minimal te energjise nga nje gender e akredituar dhe kjo duhet te vertetohet me kopje te noterizuar per vitin 2022.*
Kjo kerkese e AK-se, fillimisht eshte plotesisht e paqarte se nuk ka vlera te percaktuara saktesisht ne baze te te cilave do te mund te behej vleresimi i drejte dhe i paanshem i ofertave te dorezuara nga OE. Kerkesa eshte e panevojshme per faktin se AK ne specifikimet teknike te produktit ka definuar shume qarte vlerat e energjise: **"Energjia elektrike 100-240V, 50-60Hz".**
Derisa me kerkesen per noterizim e rendon edhe me teper procesin, sepse po kerkon dokumente qe nuk mund te dorezohen nga operatoret.
Nga Organi shqyrtues i prokurimit kerkojme qe te largoj kete kriter, kriter ky i cili nuk po mundeson qe produktin e kerkuar ta ofertojme, derisa vetem me kete certifikate AK mund te na e ndalojne dhe pamundosje ofertimin. Ky kriter nuk egzistonte ne aktivitetin e njejt te mehershem te Anuluar nga AK per te njejtin qellim.

Kriteri Nr.5, tek FDT pika 9.1&9.2:
Ne kete kriter te vendosur ne DT, *AK ka kerkuar deshmi se produkti posedon teknologjine e fundit per mos demtimin e syrit te lexuesit dhe kjo duhet te percillet me kopje te certifikates valide IEC EN62471 apo nga ndonje institucion i akredituar.*
Prandaj, duke marre parasysh se AK ka percaktuar standardin qe duhet te plotesoje ekrani i tabeles se menqur tek specifikat teknike: **4K UHD, (3840 × 2160), Direct led DLED, Xhami: kundër shkëlqimit, Shkëlqimi (maksimumi): ≥ 350 cd/m,** AK prap me kerkesen per kete certifikate ben diskriminim dhe pamundeson pjesemarrjen ne ofertim.
Nga Organi shqyrtues i prokurimit kerkojme qe te largoj kete kriter i cili nuk po na mundeson qe produktin e kerkuar ta ofertojme, deri sa vetem me kete certifikate AK mund te na e ndalojne dhe pamundesoj ofertimin, pasi qe teknikish sipas angazhimeve ne jemi te pergjegjshem dhe kerkojme te na lejohet pjesemarrja ofertimi duke larguar kete kriter apo certefikate te panevojshme dhe diskriminuese. Ky kriter nuk egzistonte ne aktivitetin e njejt te mehershem te Anuluar nga AK per te njejtin qellim.

Kerkesa 2:

1. Smartboard duhet te kete lidhje interneti port: RJ45 (x2) 100 baseT.
Kerkojme qe te largohet njeri port dhe te mundesohet ofertimi i smartboard me te pakten 1 port RJ45. Per kete kriter teknik nuk pranuam pergjigje as ne kerkese per *Sqarime Shtese* as ne *Kerkese per Rishqyrtim.*
Prandaj kerkojme qe Organi shqyrtues i prokurimit te shtjelloj kerkesen per Port RJ45 dhe te kemi nje pergjigje te sakte dhe te qarte.

2. Te specifikat teknike minimale eshte edhe kerkesa: Gjuha e programit Shqip/Anglisht.
Ne kerkesen tone per Sqarime Shtese si dhe Kerkesen per Rishqyrtim, ne si OE nuk kemi marre pergjegje nga ana e AK-se fare as per kete pike, ku kerkojme nje pergjegje te qarte rreth speccifikimit te gjuhes shqipe per tabelat e mencura sepse keto tabela do te perdoren ne Kosove nga profesoret dhe nxenesit e Kosoves.
Kerkesa teknike e kerkuar nga AK: **Gjuha e programit: Shqip /Aglisht,** kerkesa ku thuhet ***gjuha e programit*** eshte kerkese e manget dhe jo 100% e kuptueshme andaj per kete kerkuam sqarime nga AK.
Prandaj kerkojme qe Organi Shqyrtues i prokurimit te shtjelloj kete kerkese per te cilen neve nuk na jane pergjigjur AK.

Prandaj, bazuar ne tere kerkesat tona drejtuar Autoritetit Kontraktues:
- per porte **RJ45**, ***(pa pergjigje nga ana e AK),***
- per specifikacion teknik se cilit duhet ti permbahemi **A** apo **B**, ***(pa pergjigje nga ana e AK),***
- per largimin e certefikatave te cilat jane te vetmet qe na pamundesojne pjesemarrjen,
- per sqarimin Gjuha e programit: Shqip/Aglisht, ***(pa pergjigje nga ana e AK)***

Kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit te mundesoj qe te kemi pergjigje per kerkesat tona dhe te beje analizimin e kerkesave apo kritereve diskriminuese ne kete projekt, te na mundesoj ofertimin pasiqe jemi te interesuar per ofertim.

Per rikujtimin tuaj, per kete aktivitet prokurimi KK Prishtine ka pasur tender edhe me heret dhe ishin kerkesa administrative jodiskriminuese, projekt i cili eshte Anuluar nga Komuna e Prishtines dhe riperseritur me ***produktin e njejte, sasine e njejte, buxhetin e njejte****, mirepo per cudi me rastin e rihapjes se ketij projekti jane vendosur keto kritere (certifikata) te cilat jane te vetmet qe na pamundesojne ofertimin, derisa presim nga OSHP qe te largoj keto kritere, te na ofrohen pergjigjet rreth pyetjeve te tjera dhe te na mundesohet pjesemarrja ne projekt*

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/a

(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër). ///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "BOTEK SH.P.K." Future BITS shp.k.

Në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë janë kërkuar këto kritere ku janë edhe pretendimet ankimore të OE ANKUES

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kapaciteti teknik dhe professional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizim në vlerë minimale prej 600.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).	**1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve.**
2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme OE duhet te kete nje Një Menaxher i kontratës bachelor apo master në fakultetin ekonomik drejtimi menaxhment. b) Min 1 person të Teknologjisë Informative	**3. Vendimi për caktimin e Menaxherit të kontratës i vulosur dhe i nënshkruar nga OE, po ashtu duke ja bashkangjitur edhe CV-në me të gjitha të dhënat e nënshkruar nga personi i caktuar i cili duhet te jetë i diplomuar ne fushen e menaxhmentit,se paku 3 vite përvoje pune, duke ja bashkangjitur; - Kopjen e diplomës universitare Bachelor ose Master, të noterizuar në origjinal, -Kopjen e kontratës së punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit në origjinal ose e noterizuar nga noteri.**
3. OE apo prodhuesi duhet te jetë e licencuar me standardet si në vijim a) ISO	**3. Kopja e licencave dhe certefikatave me validitet për vitin 2022.**

9001 2015; b) Certefikaten c) ISO 14001, ISO 54001 d) Prodhuesi duhet te paraqes certefikatat e CE, FCC dhe ROHS per eksport ne Evrope.	
4. OE duhet të paraqes se produkti duhet te posedoj certefikaten e kualitetit per shpenzim minimal te energjise nga nje qender e akredituar.	**4. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin 2022**
5. Prodhuesi OE duhet te paraqes deshmi se produkti posedon teknologjine e fundit per mos demtimin e syrit te lexuesit.	**5. Kopja e certefikates valide IEC EN62471**
6. Operatorët Ekonomik duhet të kenë autorizimin nga prodhuesi (MAF) apo distributori (DAF) për produktet e ofruara	**6. Autorizimi i nënshkruar dhe i vulosur nga prodhuesi apo distributori në emër të Operatorit Ekonomik ofertues**
7. Operatorët Ekonomik duhet të kenë Deklaratë për garancionin e produkteve	**7. Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik poashtu Deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur nga prodhuesi i produktit apo distributori.**

Përgjigje në Pretendimi nr.1 **"BOTEK SH.P.K."**

Sa i përketë pretendimit ankimor se ky kriter është diskriminues ku është kërkuar **4. OE duhet të paraqes se produkti duhet te posedoj certefikaten e kualitetit per shpenzim minimal te energjise nga nje qender e akredituar.**
4. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin 2022
Eksperti shqyrtues vlerson që ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që për këtë produkt mund të kërkohen qertifikatat e tilla të cilat mund të verifikohen në websiten e tyre. Paisjet e kërkuara në këtë aktivitet të prokurmit janë të vendeve të ndryshme dhe është e pa mundur që të noterizohet nga OE të cilët operojn në Rep. e Kosovës.Andaj si ekspert shqyrtues vlersojn që ky kriter duke kërkuar që qertifikata të jetë e noterizuar duhet të korigjohet pra mjafton si e till pasi që mund të verifikohet shumë lehtë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 **"BOTEK SH.P.K."**

Sa i përketë pretendimit ankimor **Prodhuesi OE duhet te paraqes deshmite e**

nevojshme qe produkti ka kaluar testet kunder zjarrit. 6. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin
2022 . Ky pretendim ankimor i përfshirë në ankese nuk qëndron pasi që Autoriteti Kontraktues më 06.01.2023 e ka larguar si kriter të dosjes së tenderit duke e korigjuar edhe dosjes e tenderit pra më **06.01.2023.**

Përgjigje në Pretendimi nr.3 **"BOTEK SH.P.K."**

Sa i përketë pretendimit ankimor se është shkel neni 53 i LPP-së-Sigurimi i Informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit si ekspert shqyrtues vlersoj që çdo AK është i obliguar të ju përgjigjet OE lidhur me kërkesat për sqarime.OE Botek sh.p.k. pretendon që AK nuk ju ka përgjigjë në kërkesen e tyre për sqarime.
OE Botek sh.p.k. brenda afatit ligjot ka bërë pyetje lidhur me kapacitetit teknik dhe profesional :

3. OE apo prodhuesi duhet te jetë e licencuar me standardet si në vijim a) ISO 9001 2015; b) Certefikaten c) ISO 14001, ISO 54001 d) Prodhuesi duhet te paraqes certefikatat e CE, FCC dhe ROHS per eksport ne Evrope.

3. Kopja e licencave dhe certefikatave me validitet për vitin 2022.

Me këtë rast ka kërkuar sqarim për qertifikaten ISO 54001 e që duhet të jetë 45001.Ky pretendim nuk qëndron pasi që AK ju ka përgjigjë **21.12.2022** ku thekson që:

AK konfirmon se është bërë një lëshim teknik dhe fjala është për ISO 45001

Pastaj Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës:
në muaj ose në ditë **45** ose
fillim përfundim

kushtet e veçanta

Dorëzimi	21.3	*5 ditë pas nënshkrimit të kontratës*

Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që OE nuk ka marrë përgjigje dhe AK është i obliguar që të ju përgjigjet OE në të gjitha pyetjet.

Kërkesa 3 e OE Botek dërguar AK-së

Në FDT kërkohet Garancioni 1 vit

kushtet e veçanta

Obligimet e garancionit	24.1	*3 vite garancion*

Ju lutem sa duhet të jetë kohëzgjatja e garancionit për paisjet e kërkuara.
Eksperi shqyrtues vlerson që ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që në dosje të tenderit tek specifikimet teknike garancioni i këtyre paisjeve është 1 vit ndërsa te kushtet e veqanta ky garancion kërkohet 3 vite e që është në shperputhje njëra me tjetren.Andaj AK nuk ka kthyer përgjigje në këtë pyetje sqaruesi.

Kërkesa e 4 e OE Botek sh.p.k.
Dokumenti-Përshkrimi i çmimit
Pyetja:Meqense te dokumenti "Përshkrimi i çmimit" në përshkrimim e produkti është bartje specifikimi i dosjes së kaluar të tenderit:Coax in dhe Coax aut, kërkojm nga ju që ky dokument i përshkrimi të çmimit të ringarkohet në versionin e ri në sistem në mënyrë që specifikimet në të te jenë të njëjta me dosjes e tenderit ANEKS 1.
Te ky pretendim ankimor AK është dashur ti kthej përgjigje OE, mirpo është përgjegjësi dhe kompetenc e AK-së se çfarë versioni të përshkrimit të çmimit ta ngarkoj në sistem . Pra ky pretendim ankimor është i **pa bazuar pasi që me 06.01.2023 është ngarkuar dosja e re dhe specifikimet teknike përputhen në tërësi me përshkrimin e çmimeve.**

Kërkesa e 5 e OE Botek sh.p.k.

Kapaciteti teknik dhe professional

3. OE apo prodhuesi duhet te jetë e licencuar me standardet si në vijim a) ISO 9001 2015; b) Certefikaten c) ISO 14001, ISO 54001 d) Prodhuesi duhet te paraqes certefikatat e CE, FCC dhe ROHS per eksport ne Evrope.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
3. Kopja e licencave dhe certefikatave me validitet për vitin 2022.

Kërkesë:

Sqarim: Për prodhuesit amerikan, të cilët duan që produktet e tyre t'i sh europian, ata duhet të pajisen me certifikatë CE. Për të përfituar k prodhuesi fillimisht duhet të ketë kaluar testimet për FCC.

Rrjedhimisht, prodhuesi i pajisur me CE ka kaluar këto testime. Për vër janë raportet e testimeve (test report) të cilat janë mëse të mjafueshme p testimin e produktit për FCC.

Andaj, kërkojmë nga ju që të ndryshohet kjo kërkesë dhe si dokument certifikatën FCC, të pranohet edhe dokumenti: Test report. Apo edhe te la per FCC pasi qe certifikata FCC eshte certifikim per shitje te produkt mirepo gjithnje duke dorezuar certiikate CE e cila eshte kerkese valide Evrope.

Sa i përketë kësaj kërkese Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që paisjet të jenë të kualitetit të lart dhe dëshmin të cilen e ka kërkuar për këto qertifikata është ligjore dhe në harmoni me specifikat e kërkuara. Andaj AK është dashtu që ti kthej përgjigje OE i cili ka bërë pyetje për këtë çështje edhe pse kërkesa e AK është e qartë. Ky pretendim ankimor është i bazuar vetëm për faktin që AK-ja nuk ka kthyer përgjigje në pyetjen e parashtruar nga OE.

Kërkesa e 6 e OE Botek sh.p.k.

Kapaciteti teknik dhe professional

4. OE duhet të paraqes se produkti duhet te posedoj certefikaten e kualitetit per shpenzim minimal te energjise nga nje qender e akredituar.

4. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin 2022

6. Prodhuesi OE duhet te paraqes deshmite e nevojshme qe produkti ka kaluar testet kunder zjarrit.

6. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin 2022

7. Prodhuesi OE duhet te paraqes deshmi se produkti ka kaluar testin e ndryshkjes korrizonit

7. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin 2022

Si të tilla, ato nuk mund të noterizohen, pasi që sipas Ligjit të Note 06/L-010, Neni 47- Vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale, në lejohet noterizimi i kopjeve të dokumenteve (në këtë rast certifikatave

Duke marrë parasysh se qëllimi i noterizimit të dokumenteve është vër se tyre, kjo kërkesë nuk është e arsyeshme, pasi që vlefshmëria certifi mund të vërtetohet përmes nr të certifikatës, tek web faqja e trupit lëshuar ato.

Rrjedhimisht, kjo kërkesë e juaja po kufizon konkurrencën, duke favori Kjo paraqet shkelje të LPP-së, neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskrin

Prandaj, kërkojmë nga ju si AK, që të largoni këtë kërkesë nga FD noterizuara, duke lejuar që më shumë OE të marrin pjesë në mënyrë aktivitet të prokurimit.

Sa I për ketë këtij pretendimi ankimor për piken 4 e kemi sqaruar në fillim ndërsa piken 6 dhe 7 AK-ja i ka larguar nga dosja e tenderit duke e ngarkuar dosjen e re në e-prokurim më 06.01.2023 andaj ky pretendim është i pabzuar

Përgjigje në Pretendimi nr.1 " **Future BITS sh.p.k.**

1. Sqarime Shtese me datë 19.12.2022, ku pas pranimit te vendimit te Ak **22.12.2022** ndaj sqarimeve shtese nuk pajtohemi me pergjigjet e autorite pyetje shume te rendesishme per kete aktivitet qe i kemi parashtruar nuk fare.

Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që AK-ja nuk ka dhënë përgjigje OE të cilët kanë kërkuar sqarime.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 " **Future BITS sh.p.k**

2. Kërkesën për Rishqyrtim me datë 23.12.2022, ku kemi kerkuar te largohen kriteret diskriminuese ne **FDT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** pika **9.1 & 9.2** me numrat rendor **4,5,6,7** dhe kerkesat e tjera per **specifikimet teknike** dhe **cilit specifikim duhet ti permbahemi.**

Autoriteti Kontraktues vendos qe te largoj nga formulari i dosjes se tenderit ne piken 9.1. dhe 9.2., kriterin me nr.6, 7 dhe 10.

Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që në Vendimin e Kërkesës për Rishqyrtim pra largon kriteren nr.6,7 dhe 10 e që është e drejt e AK-së se cilat kritere ti vendos në dosje të tenderit mirpo konform Kërkesës për Rishqyrtim AK-ja është dashtë të kthej përgjigje për të gjitha pretendimet ankimore dhe në të gjitha pyetjet e parashtruara nga OE.

Përgjigje në Pretendimi nr.3 " **Future BITS sh.p.k**

AK, nuk na eshte pergjigjur fare rreth pyetjeve te **specifikimit teknik** dhe pavaresisht operatoreve ekonomik AK nuk mundet ne asnje rrethane te vazhdoj kete aktivitet derisa te rregulloj kriteret e brendshme te aktivitetit, sepse autoriteti kontraktues ka 2 specifikime teknike per te njejtin aktivitet, e qe eshte ne kundershtim me LPP-ne, e per kete edhe kemi bere pyetje ne sqarime shtese dhe kerkese per rishqyrtim mirepo jemi pa pergjigje. Ne kerkojme prap te na sqarohet se cilit specifikim duhet ti permbahen operatoret sepse ka dy specifikime ne Eprokurim per te njejtin aktivitet: ***a). Specifikacion-tabelat interactive*** *dhe* ***b). Përshkrimi i çmimeve,***

Prandaj kerkojme qe Organi shqyrtues i prokurimit te shtjelloj se cilit specifikim duhe ti permbahemi a) *apo* ***b), pasiqe eshte kushti kryesor dhe i vetem ne baze te cilit do te behet evaluimi si dhe vertetimi i pergjegjshmerise se ofertuesve, AK per kete kerkese duhej te na ofronte pergjigje.***

Edhe ky pretendim ankimor është I pa bazuar pasi që AK-ja e ka korigjur dosjen e tenderit më 06.01.2023 ora 13:43 dhe të ngritur në sistemin e e-prokurimit dhe ku përshkrimi I çmimeve përputhet në tërësi me specifikimet teknike të dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimi nr.4 " **Future BITS sh.p.k**

KERKESA 1:

Ne FDT te ***Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale*** *pretendojme se jane bere kerkesa te cilat jane totalisht te paqarta d kriteret e mbetura (certifikatat)* ***Nr.4 dhe 5,*** *te cilat duhet larguar mundesohet pjesemarrja me kritere te drejta, te barabarta e jo diskriminu*

Kriteri Nr.4, tek FDT pika 9.1&9.2:

Ne kete kriter te vendosur ne DT, *AK ka kerkuar qe produkti i ofruar te kualitetit per shpenzim minimal te energjise nga nje qender e akredit vertetohet me kopje te noterizuar per vitin 2022.*

Kjo kerkese e AK-se, fillimisht eshte plotesisht e paqarte se nuk ka

saktesisht ne baze te te cilave do te mund te behej vleresimi i drejte dhe i paanshem i ofertave te dorezuara nga OE. Kerkesa eshte e panevojshme per faktin se AK ne specifikimet teknike te produktit ka definuar shume qarte vlerat e energjise: **"Energjia elektrike 100-240V, 50-60Hz".** Derisa me kerkesen per noterizim e rendon edhe me teper procesin, sepse po kerkon dokumente qe nuk mund te dorezohen nga operatoret.

Ky pretendim ankimor është pjesërisht I bazuar pasi që kjo kërkesë mjafton te jetë certificate e cila nuk duhet kërkuar e noterizuar pasi që shumë lehtë mund të verifikohet në veb site të paisjeve. Pra mjafton kjo qertifikat e cila nuk duhet të kërkohet e noterizuar **(Ky pretendim ankimor për këtë çertifikat e kamë sqaruar edhe te OE Botek sh.p.k.)**

Përgjigje në Pretendimi nr.5 " **Future BITS sh.p.k.**

Kriteri Nr.5, tek FDT pika 9.1&9.2: Ne kete kriter te vendosur ne DT, *AK produkti posedon teknologjine e fundit per mos demtimin e syrit te lexu percillet me kopje te certifikates valide IEC EN62471 apo nga ndonje istitu* Prandaj, duke marre parasysh se AK ka percaktuar standardin qe duhe tabeles se menqur tek specifikat teknike: **4K UHD, (3840 × 2160), Dir kundër shkëlqimit, Shkëlqimi (maksimumi): ≥ 350 cd/m,** AK prap m certifikate ben diskriminim dhe pamundeson pjesemarrjen ne ofertim.
Nga Organi shqyrtues i prokurimit kerkojme qe te largoj kete kriter i cili qe produktin

Ky pretendim ankimor si ekspert shqyrtues vlersojn që është I pa bazuar pasi që AK-ja ka interes që të furnizoj me paisje të teknologjisë me të mire.Shumica e këtyre paisjeve të teknologjisë me të re janë paisje të avansuar dhe të cilat nuk I dëmtojn syt e përdorueseve dhe lexuesëve.

Përgjigje në Pretendimi nr.6 " **Future BITS sh.p.k.**

Kerkesa 2:
1. Smartboard duhet te kete lidhje interneti port: RJ45 (x2) 100 baseT.
Kerkojme qe te largohet njeri port dhe te mundesohet ofertimi i smartbo port RJ45. Per kete kriter teknik nuk pranuam pergjigje as ne kerkese per *Kerkese per Rishqyrtim.*
Prandaj kerkojme qe Organi shqyrtues i prokurimit te shtjelloj kerkesen kemi nje pergjigje te sakte dhe te qarte.

Te ky pretendim ankimor AK-ja është dasht që të kthej përgjigjje, megjithatë AK ka kompetencen e saj që të vendos specifikimet teknike konform nevojave të saj dhe **JO** sipas dëshirave dhe kërkesave të OE. Andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.7 " **Future BITS sh.p.k.**

2. Te specifikat teknike minimale eshte edhe kerkesa: Gjuha e programit
Ne kerkesen tone per Sqarime Shtese si dhe Kerkesen per Rishqyrtim, ne pergjegje nga ana e AK-se fare as per kete pike, ku kerkojme nje pergjegje speccifikimit te gjuhes shqipe per tabelat e mencura sepse keto tabela do Kosove nga profesoret dhe nxenesit e Kosoves.
Kerkesa teknike e kerkuar nga AK: **Gjuha e programit: Shqip /Aglisht,** ker ***e programit*** eshte kerkese e manget dhe jo 100% e kuptueshme andaj pe sqarime nga AK. ***Prandaj kerkojme qe Organi Shqyrtues i prokurimit te sl per te cilen neve nuk na jane pergjigjur AK.***

Te ky pretendim ankimor AK-ja është dasht që të kthej përgjigjje, megjithatë AK ka kompetencen e saj që të vendos specifikimet teknike konform nevojave të saj dhe JO sipas dëshirave dhe kërkesave t OE. Andaj ky pretendim ankimor është I pa bazuar pasi që kërkesa është e qartë.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si **PJESËRISHT TË BAZUAR** dhe të bëhet korigjimi i dosjes së tenderit në disa prej kritereve të potencuara në ekspertiz dhe të përgjigjet ne të gjitha pyetjet e OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - . **BOTEK SH.P.K. dhe Future BITS shp.k.**